



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:084399

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06000879

KPPP.nr.503/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Miftari - Commerce” N.T.SH., me NUI: 810458241, me seli në Fushë Kosovë, Bresje, përfaqësuar sipas autorizimit nga Teutë Xhema, avokate nga Prishtina, kundër debitorit “Market Caprilla” SH.P.K., me NUI: 811987794, me seli në Lipjan, Magjistralja Prishtinë - Ferizaj, përfaqësuar sipas autorizimit nga Nebih Torushpa, avokat nga Lipjani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.107/24 të datës 21.02.2024, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Market Caprilla” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.107/24 të datës 21.02.2024, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.107/24 i datës 21.02.2024, i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi
- IV. URDHËROHET debitori “Market Caprilla” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 3,100.00 € (tre mijë e një qind euro), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

- V. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Miftari - Commerce” N.T.SH., ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 0107200001 të datës 20.07.2023 dhe Faturës Nr. 0108250001 të datës 25.08.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 3,100.00 €, me kamatë ligjore 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm ashtu që përmbartimi të bëhet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim në të cilin ndër të tjerash ka theksuar se kreditori nuk i ka përfunduar punët sipas marrëveshjes, ndërsa punët e përfunduara janë jashtë çdo standardi. Tutje ka shtuar se faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbartimore nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 i LPP-së, pasi që nuk është specifikuar se sa është shuma e paguar e faturave, sa është shuma e mbetur si dhe faturat e kthimit të mallit, po ashtu nuk është e qartë se nga cili raport juridik burojnë këto fatura, kur është krijuar ky raport si dhe a ka kaluar afati i parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që të anulohet urdhri përmbartimor, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumë prej 104.00 €.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke theksuar se, kreditori ka dorëzuar faturat e rregullta tek debitori, sa i përket pretendimeve për të metat e mallit ka deklaruar se debitori nuk i ka paraqitur kundërshtimet e tij brenda afatit të paraparë sipas LMD-së. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta obligoj debitorin që kreditorit që t’ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumën prej 150.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se

prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr. 0107200001 të datës 20.07.2023 dhe Faturën Nr. 0108250001 të datës 25.08.2023, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekur i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë nënshkrimin e pranimit të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar nga debitori.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk

lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të neneve 452 par.1, 453 dhe 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur kreditorit shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësimin dhe atë në shumën prej 104.00 €.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast të parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.503/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.